

QARKU I DIBRËS - 85 Monumente

Rrethi Dibër - 40 Monumente Natyre

17 gjeomonumente:

1. Karsti i Malit të Bardhë. Gjendet pranë fshatit Sllovë në formën e një peizazhi karstik në gjipset e permo-triasit. Dallohet për ngjyrën e bardhë, lapiezet, gropat e hinkat, shpellat karstike, që nuk njihen, dhe vlerat gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi Sllovë-rruga këmbësore tek Mali i Bardhë.

2. Shpella e Gurit të Kuq. Gjendet afër fshatit Vakuf, 500 m mbi nivelin e detit. E formuar në shkëmbinj gëlqerorët të trias-jurasit, është 400 metra e gjatë, 2-3 m e gjerë dhe 4 m e lartë, shumë e pasur me konkrecione. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi–Vakuf.

3. Shpella e Rusit. Gjendet në fshatin Grykë Nokë (Dibër), 710 m mbi nivelin e detit. E formuar në gëlqerorët e trias-jurasit, është ende e paeksploruar. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Selishtë-Grykë Nokë.

4. Shpella e Qytezës. Gjendet afër fshatit Bellovë, komuna Melan. Njihet edhe me emrat Kepi i Xhitetit dhe Kodra e Nullave. E formuar në gjipset e permo-triasit, ende nuk është eksploruar. Përmasat e njohura: gjatësi 10 metra, gjerësi 2 m dhe lartësi 3 m. Ka mbetje të aktivitetit të njeriut të lashtë, vlera gjeomorfologjike, arkeologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Bellovë.

5. Shpella e Akullit (Bulaç). Gjendet pranë fshatit Muhur, 1000 m mbi nivelin e detit. Është formuar në gëlqerorët e trias-jurasit. Pjesa e njohur e saj është e gjatë 50 metra, e gjerë deri në 3 m. dhe e lartë 2 m. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Bellovë-monumenti.

6. Pasqyrat e Gramës. Gjendet në malin e Gramës, pranë fshatit Sllovë, 1900 m mbi nivelin e detit. Zhveshja gjipsore e llojit selen shkëlqen. Ka gjatësi rreth 500 metra, gjerësi rreth 200 m. dhe vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike),

didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi–Sllovë-rruga këmbësore tek monumenti.

7. Gropa e Panairit. Gjendet afër fshatit Radomirë, 2115 m mbi nivelin e detit. Përbën cirk glacio-karstik në rreshpe, me gjatësi 800 m e gjerësi 230 m, formë amfiteatri. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, ekologjike, turistike. Vizitohen sipas rrugës Peshkopi-Radomirë.

8. Bjeshka e Zonjave në Gramë. Gjendet në Malin e Korabit, 1700 m mbi nivelin e detit. Përbën shpatullim akullnajor në rreshpe, 1000 metra i gjatë, 100-180 m i gjerë. Në formën e ballkonit natyror me kullota alpine, ka vlera shkencore gjeomorfologjike, ekologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi-Zimur-rruga këmbësore te monumenti.

9. Gryka e Setës. Gjendet në pjesën më të thellë të luginës së Setës (degë e Drinit të Zi), formuar në gëlqerorët e triasi- jurasit nga lumi dhe karsti. Është 1.5 km i gjatë, 100-150 m i thellë, 4-7 m i gjerë. Përbën një ekosistem karstik me vlera shkencore (gjeomorfologjike, biologjike), didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi-Kukës.

10. Gryka e Mall Lurës. Gjendet në sektorin e mesëm të luginës së Mall Lurës (degë e Drinit të Zi), 380 m mbi nivelin e detit. E formuar në gëlqerorët e triasi-jurasit, është e gjatë rreth 1,3 km, i thellë rreth 50 m dhe i gjerë 5-6 m. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike, biologjike), didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi-Fushë Lurë.

11. Shllinasi. Gjendet në Malin e Bardhë, pranë fshatit Sllovë, 1200 m mbi nivelin e detit. Përbën një gur gjipsi dhe kripe guri, 900 metra i gjatë, i gjerë deri në 250 m dhe deri në 200 m i lartë, që lëpihet nga dhitë e egra. Ka vlera shkencore gjeologjike, didaktike, ekologjike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Sllovë.

12. Guri i Kërçinit. Gjendet pranë fshatit Kërçisht, 2000 m mbi nivelin e detit. Përbën një gur gëlqeror të kretës së sipërme, rreth 12 ha., ku organizohen festa fetare e pagane. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, fetare. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi-Kërçisht.

13. Rrafshi i Korabit. Gjendet afër fshatit Radomirë, 1900 m mbi nivelin e detit. Përbën një cirk kompleks akullnajor, 1000 m i gjatë dhe 200 m i gjerë, me formën

e një amfiteatri. Ka kullota të pasura alpine, vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike etj. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Radomirë.

14. Morenat e Fushë Lurës. Gjendet afër fshatit Fushë Lurë, 1100 m mbi nivelin e detit. Përfaqësohen nga depozitime morenike, 1.3 km të gjatë, 350 m të gjerë, të ardhura nga cirku i Liqenit të Madh, të veshura me pyje ahu e pishe. Kanë vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike. Vizitohen duke ndjekur rrugën rurale Peshkopi-Fushë Lurë.

15. Cirku i Kurorës së Lurës. Gjendet në malin me të njejtin emër, 1830 m mbi nivelin e detit. Përbën cirk akullnajor në shkëmbinjtë magmatikë, me gjatësi 900 metra, gjerësi deri 350 m e formë poltroni. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale qyteti i Peshkopisë-Fushë Lurë.

16. Kodra e Parave (Bllicë). Gjendet afër fshatit Kukaj, 493 m mbi nivelin e detit. Kodra ka formë kupole. Sipas legjendës, këtu, të parët kanë fshehur thesarin. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale Peshkopi-Kukaj.

17. Fusha e Pelave. Gjendet në Parkun Kombëtar të Lurës, 1580 m mbi nivelin e detit. Përbën cirk akullnajor. Ishte e mbuluar nga liqeni, që u tha. Kullota e saj pëlqehet nga pelat. Fusha me bukuri mahnitëse, ka vlera shkencore biologjike, didaktike, ekologjike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi- Fushë Lurë, ose Rëshen-Fushë Lurë.

12. Hidromonumente:

18. Liqeni i Luleve. Me sipërfaqe rreth 45 ha, gjendet në cirk akullnajor në Parkun Kombëtar të Lurës, në Kurorën e Lurës, 1600 m mbi nivelin e detit. Është liqen akullnajor. Dallon për zambakët e bardhë me bukuri të rrallë që çelin në qershor. Ka vlera shkencore (hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi–Fushë Lurë.

19. Liqeni i Zi. Me sipërfaqe rreth 3 ha, gjendet në Parkun Kombëtar të Lurës, në Kurorën e Lurës, në cirk akullnajor, mbi 1600 m mbi nivelin e detit. Është liqeni akullnajor më i thellë, prandaj ka ngjyrë të zezë. Ka vlera shkencore (hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Fushë Lurë.

20. Liqeni i Madh. Me sipërfaqe rreth 50 ha, gjendet në Parkun Kombëtar të Lurës, në Kurorën e Lurës, në cirk akullnajor, mbi 1600 m mbi nivelin e detit. Dallohet për ujë të pastër, botë të gjallë të larmishme, ndërsa gjatë verës mbulohet nga zambakë të mëdhenj e të bardhë. Ka vlera shkencore (hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Fushë Lurë.

21. Liqeni i Zi (mbi Radomirë). Me sipërfaqe rreth 0,8 ha, gjendet në malin e Korabit, pranë fshatit Radomirë, mbi 2200 m mbi nivelin e detit. Është liqen akullnajor. Ka vlera shkencore (biologjike, hidrologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohet, duke marrë rrugën rurale Peshkopi-Radomirë.

22. Liqenet e Kacnisë. Gjendet në malin Balgjaj (Allaman), afër fshatit Kacni. Janë liqene akullnajorë në cirqe: me gjatësi 50-100 m, gjerësi 20-35 m, thellësi mbi 5–6 m e sipërfaqe disa ha. Uji i pastër, pyjet halorë përreth, formojnë ekosistem të liqeneve alpinë, tepër tërheqëse. Kanë vlera shkencore (hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike, turistike. Vizitohen sipas rrrugës rurale Bulqizë-Maqellarë–Kacni ose ajo pyjore, Qafë Murrë-Balgjaj.

23. Ujëvara e Pocestës në Maqellarë. Gjendet në malin e Deshatit, 1500 m mbi nivelin e detit. Uji del në lartësinë 13 m përgjatë një të çarë të shkëmbit gëlqeror. Formon një mjedis me bukuri mahnitëse, vlera shkencore hidrologjike, didaktike turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi–Maqellarë-monumenti.

24. Uji i Ftohtë (Vleshë). Gjendet pranë fshatit Vleshë, 800 m mbi nivelin e detit. Del në kontaktin midis gëlqerorëve dhe rreshpeve. Me ujin e pastër, krijon mjedis tërheqës dhe vlera shkencore hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi- Vleshë.

25. Burimi karstik i Kërçinit. Gjendet në fshatin Kërçin, 1670 m mbi nivelin e detit. Del në kontaktin midis gëlqerorëve dhe terrigjenëve. Me ujin e pastër dhe

mjedisin tërheqës përreth, ka vlera shkencore hidrologjike, didaktike, turistike. Vizitohet me rrugën Peshkopi-Kërçisht.

26. Kroi i Mbretit. Gjendet në afërsi të fshatit Serakol, 1200 m mbi nivelin e detit. Del si burim karstik në kontaktin midis gëlqerorëve dhe terrigjenëve. Ujërat dhe peizazhi përreth, formojnë mjedis shlodhës. Ka vlera shkencore hidrologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Serakol.

27. Burimi termomineral i Llixhave të Peshkopisë. Gjendet afër qytetit të Peshkopisë, në luginën e përroit të Banjave. Lidhet me shkëputjen tektonike. Ujërat me temperaturë rreth 400 C, kripëra dhe gaze të tretura kurojnë reumatizmen, artritet, poliartrit. Pacientët vijnë nga gjithë Shqipëria në mjedise hotelerie me shërbim mjekësor. Kohët e fundit investimet janë rritur. Kanë rëndësi shkencore (gjeologjike, hidrogeologjike), ekonomike, didaktike etj. Vizitohen sipas rrugës rurale Peshkopi-Llixha.

28. Burimet e Bellovës. Gjenden në fshatin me të njëjtin emër, komuna Melan. Janë burime karstike, që dalin në kontaktin midis gjipseve dhe rreshpeve. Me ujin e pastër krijojnë mjedis tërheqës, që u japin vlera shkencore hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale Peshkopi-Bellovë.

29. Burimi dhe shpella e Sopanikës. I pari hidromonument dhe i dyti gjeomonument pranë fshatit Fushë Çidhnë. Burimi karstik, me prurje 150 l/sek., del në kontaktin midis gëlqerorëve dhe terrigjenëve, ndërsa shpella karstike është ende e paeksploruar. Ka filluar ndërtimi i ujësjellsit që do të marrë ujë prej tij. Kanë vlera gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Çidhnë.

11. Biomonumente

30. Krasta e Pocestit. Gjendet afër fshatit Pocestë, 1500 m mbi nivelin e detit, në territore gëlqerore të karstëzuara. Është një habitat me shkozë, ah, lajthi, panjë, frashër, mollë e vodhë të egër, dëllinjë, etj. Ka vlera shkencore biologjike, didaktike etj. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Pocestë.

31. Boroviku i Begiunecit. Gjendet pranë fshatit Rabdishtë, 800-1350 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson habitat në territor gjipsor të karstëzuar me pishë, ah, lajthi, panjë, frashër, dushk, etj, në të cilin gjenden kaproll, dhi të egra, etj. Ka vlera biologjike, didaktike, etj. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Rabdishtë.

32. Hartinat e Lurës. Gjendet në Parkun Kombëtar të Lurës, afër fshatit Fushë Lurë, 1600 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një grup drurësh me lartësi 30 m, diametër trunq rreth 70 cm dhe moshë mbi 100 vjet. Kanë vlera shkencore biologjike, ekologjike, kulturore, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Fushë Lurë.

33. Rrapi i Kërçishtit. Gjendet në fshatin me të njëjtin emër, komuna Maqellarë, rreth 700 m mbi nivelin e detit. Është dru rrap me moshë mbi 180 vjet, lartësi mbi 25 m, diametër trunq 200 cm e perimetër 550 cm, ndërsa i kurorës rreth 60 m. Ka vlera biologjike, didaktike, estetike, historike. Vizitohet sipas rrugës rurale Maqellarë-Kërçisht.

34. Pisha e Bllicës. Biomonument pranë fshatit Bllicë, komuna Fushë Ali. Përfaqëson dru pishë të zezë, me diametër trunq mbi 2,2 m, perimetër rreth 5 m dhe moshë mbi 120 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Bllicë-lagjja Shepë.

35. Ahu i Bllicës. Gjendet afër fshatit Bllicë, komuna Fushë Alisë, rreth 500 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru ah me lartësi mbi 15 m, diametër i trunqut mbi 210 cm, perimetër të kurorës mbi 30 m dhe moshë mbi 160 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopisë-Bllicë.

36. Lisi i Dobit. Gjendet pranë fshatit Fushë Muhur, rreth 500 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru me lartësi mbi 25 m, diametër të trunqut rreth 110 cm e perimetër mbi 320 cm, moshë mbi 160 vjeçare, me 30 degë e kurorë ombrellore me perimetër mbi 78 m. Ka vlera shkencore biologjike, historike, turistike. Vizitohet me rrugën Peshkopi-Fushë Muhur.

37. Lisi Kabe. Gjendet në fshatin Kabe të komunës Tominë, 650 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru me lartësi mbi 20 m, diametër të trunqut mbi 140 cm e perimetër mbi 420 cm dhe moshë mbi 140 vjeçare. 25 degë formojnë kurorë

ombrellore me perimetër 55 m dhe vlera shkencore biologjike, didaktike, estetike e turistike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale Peshkopi-fshati Kabe.

38. Vakufi i Sinës së Epërme. Gjendet afër fshatit Sinë, komuna Arras.

Përfaqëson pyll (2 ha), me drurë mbi 25–30 m të lartë dhe diametër trunq mbi 70 cm. Ka vlera shkencore biologjike, didaktike, estetike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Sinë e Sipërme.

39. Rrobulli i Lurës. Gjendet në Parkun Kombëtar të Lurës, rreth 1800 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Gur Lurë. Dru i veçuar me 30 degë e kurorë ombrellore me perimetër 30 m; ngrihet mbi 25 m lartësi; diametri i trunqut arrin mbi 180 cm e perimetri mbi 580 cm, ndërsa mosha mbi 400 vjet. Disa degë janë të dëmtuara nga faktorët atmosferikë. Ka vlera shkencore biologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Liqeni i Luleve-Fusha e Thatë.

40. Plepi i Zi i Çidhnës. Gjendet në fshatin Çidhnë, komuna Arras, rreth 600 m mbi nivelin e detit. Janë tri plepa të zes, me lartësi mbi 28 m, diametër të trunqut mbi 130 cm e perimetër mbi 360 cm, ndërsa i kurorës rreth 39 m. Ka vlera biologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi-Çidhnë.

Rrethi Bulqizë - 17 Monumente Natyre

5 Gjeomonumente:

1. Shpella e Urës së Qytetit. Gjendet afër fshatit Valikardhë të komunës Zerqan, 650 m mbi nivelin e detit. Është formuar në gëlqerorët e trias-jurasit. Pjesa e njohur arin 30 m gjatësi, 15 m gjerësi dhe 30 lartësi. Ka konkrecione dhe vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizës-Zerqan.

2. Shkëmbi i Qytetit. Gjendet në lindje të qytetit të Bulqizës, 700 m mbi nivelin e detit. Përbën një gur magmatik, me formë piramidale. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike. Vizitohet sipas rrugës qyteti i Bulqizës-monumenti.

3. Xixëll Martanesh. Gjendet pranë fshatit Peshk, komuna e Martaneshit, 1200 m mbi nivelin e detit. Njihet edhe me emrat: Xixëlla, Xixër, ura e Qerbelasë. Është fushë e modeluar nga akujt dhe karsti. Ka formë gati ovale, mbi 1,5 km të gjatë,

gjerësi disa qindra metra. Në mes të saj gjenden: një bredh i ruajtur mirë, një burim karstik, lapidari për betejën e sheh Feze Bulqizës dhe ura e gurtë e Qerbelasë. Aty organizohen festa pagane. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike, historike), didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Qafa e Buallit–Peshk.

4. Shpella e Xixëlles (Valikardhë). Gjendet afër fshatit Valikardhë, 1000 m mbi nivelin e detit. Shpella karstike e formuar në gëlqerorët e trias-jurasikut, ende nuk është eksploruar. Legjenda e lidh me shenjtin, prandaj shërben si faltore për besimtarët. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, fetare, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizë-Valikardhë.

5. Shpella e Ftohtë Gjuras. Gjendet afër fshatit me të njëjtin emër, 920 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson shpellë karstike në gëlqerorët e trias-jurasit, 25 m e gjatë, 2 m e gjerë. dhe 2 m e lartë. Ka konkrecione të shumta dhe vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike, ekologjike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizë-Gjuras.

5 Hidromonumente:

6. Tri Çezmat e Zerqanit. Gjendet midis fshatrave Krajë dhe Sofraçan, komuna Zerqan, 700 m mbi nivelin e detit. Njihet edhe me emrin Hurdha e Priftit. Janë disa burime karstike, që dalin në kontaktin e gëlqerorëve të triasit me terrigjenët. Krijojnë mjedis shumë tërheqës e çlodhës. Kanë vlera shkencore hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizë-Krajë-Sofraçan.

7. Gurra dhe shpella e Zerqanit. Gjendet afër fshatit Zerqan, 900 mbi nivelin e detit. Përbën disa dukuri karstike, në kontaktin midis gëlqerorëve të triasit dhe terrigjenëve të paleogjenit. Krijojnë mjedis shumë tërheqës e çlodhës. Kanë vlera shkencore hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizë-Zerqan.

8. Gurra e Vakëfit të Zerqanit. Gjendet pranë fshatit Zerqan, 850 m mbi nivelin e detit. Burimi karstik del në kontaktin midis gëlqerorëve të trias-jurës e terrigjenëve. Dallohet për ujë të pastër, të ftohtë, ndërsa mjedisi përreth përdoret si rezervat i mbarështrimint të kanarinave, thëllëzave, grifshave etj. Ka vlera shkencore

hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet me lehtësi, duke ndjekur rrugën qyteti i Bulqizës-Valikardhë.

9. Liqeni i Zi. Gjendet në Martanesh, në shpatin verior të malit të Lopës, 1800 m mbi nivelin e detit. Është liqen akullnajor, rreth 45 ha, i vendosur në një cirk kompleks me gjatësi 400 m, gjerësi rreth 200 m, thellësi deri 60 m. Nga tri anë rrethohet me shpate shumë të pjerrta, të veshura me pyje ahu e pishë. Dallohet për ujë të pastër si kristali, të ftohtë dhe bukuri të rrallë. Gjatë dimrit ngrin në sipërfaqe. Ngjyra e zezë lidhet me thellësinë e madhe dhe depozitimet e kromiteve në taban të tij. Ka vlera shkencore hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike, turistike. Në periudhën komuniste u ndërtua prita për të rritur kapacitetin ujëmbajtës të liqenit, ndërsa gjatë verës prej tij u mor ujë për ujitje. Kjo dëmtoi rëndë vlerat e liqenit. Në vitin 2004 filloi ndertimi i një hidrocentrali, i cili do të përdorë ujin e liqenit dhe ujëra e tjera përreth. Kjo po i rrezikon shumë vlerat e liqenit. Vizitohet sipas rrugës rurale Qafa e Buallit-Batër Martanesh-rruga këmbësore për tek Liqeni i Zi

10. Ujëvara e Duriçit. Gjendet në shpatin verior të malit të Kaptinës së Martaneshit. Uji vjen nga Liqeni i Zi. Ujëvara me lartësi 20 m, duke krijuar pamje mahnitëse. Ka vlera të shumta estetike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizë-monumenti.

7 Biomonumente:

11. Bregu i Pepesë. Gjendet pranë fshatit Zall Sopot, 700 m mbi nivelin e detit. Njihet edhe me emrin Qarri i Pepesë. Trungu i tij arrin 15 m lartësi, diametër mbi 250 cm dhe moshë qindra vjeçare. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizës-Zall Sopot.

12. Qarri i Muharremit. Gjendet në afërsi të fshatit Krajkë, 580 m mbi nivelin e detit. Është dru me lartësi 30 m, diametër të trungut rreth 1.5 m dhe moshë mbi 220 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizë-Krajkë.

13. Qarri i Kovashicës. Gjendet në lartësinë 700 m mbi nivelin e detit, në fshatin Kovashicë të komunës Zerqan. Përfaqëson dru të veçuar me lartësi 20 m, diametër të trungut rreth 1 m e perimetër të tij rreth 120 cm, moshë rreth 250 vjet. Ka vlera

shkencore biologjike, didaktike, estetike, historike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Bulqizës-Shupenzë-Kovashicë.

14. Qarri i Gjinovecit. Gjendet rreth 1500 m mbi nivelin e detit, në fshatin Gjinovec, komuna Klenjë. Është dru me lartësi mbi 15 m, diametër të trungut mbi 80 cm e perimetër të tij mbi 150 cm, ndërsa i kurorës mbi 50 m. Ka degë të dëmtuara nga faktorët atmosferikë, dhe vlera shkencore biologjike, historike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizë-Klenjë-Gjinovec, ose Librazhdit-Klenjë-Gjinovec.

15. Pisha Zogje. Gjendet në fshatin Zogje, komuna Shupenzë, 700 m mbi nivelin e detit. Njihet edhe me emrin “Vishkulli Zogje”. Është dru pishe i veçuar me lartësi mbi 20 m, diametër të trungut rreth 1,8 m, perimetër rreth 565 cm dhe moshë mbi 110 vjeçare. Ka vlera biologjike, didaktike, estetike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizës-Kartashicë-Zogje.

16. Qarri Peladhi. Gjendet në qendër të fshatit Peladhi, në komunën Zerqan, 620 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru qarri me lartësi 18 m, diametër të trungut mbi 80 cm, perimetër mbi 250 cm e moshë mbi 150 vjet. 13 degë formojnë kurorën me perimetër mbi 31 m. Ka vlera shkencore biologjike, estetike, historike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizës- Peladhi.

17. Zabeli i Madh Zerqan. Gjendet në fshatin me të njejtin emër, 750 m mbi nivelin e detit. Njihet edhe me emrin “Vakufi i Zerqanit”. Përbën pyll dushku 15,5 ha, me drurë 15 m të lartë, diametër të trungut rreth 0.7 m dhe moshë mbi 100 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Bulqizës-Zerqan.

Rrethi Mat - 28 Monumente Natyre

7 Gjeomonumente:

1. Guri i Gjatë në Urxuall. Gjendet pranë fshatit Urxuall, komuna Derjan, 600 m mbi nivelin e detit. Me përbërje ranoro-konglomeratike, formë mullari, lartësi mbi 20 m e gjërësi 10-15 m, është formuar nga gërryerja e agjentëve atmosferikë. Në rrëzë të tij ka blloqe të rrëzuar me volum prej dhjetra m³. Këtu kalon rruga për në Urxuall e Dukagjin. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel–Derjan.

2. Kepi i Skënderbeut në Varosh. Gjendet në afërsi të fshatit Vig, 800 m mbi nivelin e detit. Njihet edhe me emrin Kalaja e Skënderbeut. Ka përbërje gëlqerore, formë afërsisht të një kërpudhe, lartësi mbi 140 m, gjërësi 25 m, gjatësi 120 m, e sipërfaqe 2 ha. Është formuar nga veprimi i faktorëve atmosferikë e tektonikë. Legjenda e lidh me Skenderbeun, i cili e përdorte atë si pikë vrojtimi. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, historike), didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Shoshaj (Burrel)-Qafë Murrë.

3. Maja e Boshtrës. Gjendet afër fshatit Macukull, 1118 m mbi nivelin e detit. Përbën gur ranor me moshë tortoniane dhe formë piramidale, të formuar nga erozioni. Është i gjatë deri në 900 m, i gjerë 500 m dhe 100 m i lartë. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike, gjeologjike), didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Shoshaj (Burrel)-Macukull.

4. Gurri i Vashës. Gjendet në afërsi të fshatit Shëlli-Vig, 850 m mbi nivelin e detit. Përbën gur gëlqeror me moshë kretake, rreth 30 m i gjatë, 20 m i gjerë, 40 m i lartë dhe formë kërpudhe, të krijuar nga karstit dhe era. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Shoshaj-Fushë Bunari-Mbasdejë

5. Puset e Valcës. Gjenden në veriperëndim fshatit Macukull, 900 m mbi nivelin e detit. Janë puse karstikë, ende të paeksploruar, me diametër 2 m, thellësi rreth 2-3 m. Në tërësi, ekosistemi karstik ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas rrugës rurale Burrel-Shoshaj-Macukull

6. Kanioni i Urakës. Gjendet në luginën e Urakës (degë e Matit), në lindje të fshatit Urakë, rreth 150 m mbi nivelin e detit. Kanioni, rreth 3 km i gjatë, deri 4-7 m i gjerë dhe rreth 100 m i thellë, është formuar në gëlqerorë, prej lumit e karstit. Në muret e tij ka guva e shpella karstike, ende të panjohura. Ka vlera shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Shoshaj-Urakë, ose Derjan-Urxuall-Dukagjin.

7. Kanioni i Flimit. Gjendet në luginën e Filmit (degë e Urakës), pranë fshatit Dukagjin të komunës Derjan, 600 m mbi nivelin e detit. I formuar në gëlqerorët e kretës nga karsti e erozioni i Flimit, është i gjatë rreth 1 km, i thellë 150 m dhe i gjerë disa dhjetra metra. Me shpate të thepisura e guva karstike, ka vlera

shkencore gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Shoshaj-Dukagjin.

2 Hidromonumente:

8. Kroi i Gjeneralit. Gjendet afër Vakëfit të fshatit Gur i Bardhë të komunës Xibër, 850 m mbi nivelin e detit. Është burim karstik me ujë të pastër e të ftohtë, që del në kontaktin e gëlqerorëve me terrigjenët, i rregulluar në formën e kroit. Ka vlera shkencore, hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Klos-Guri i Bardhë.

9. Burimi i Shutresë. Gjendet pranë luginës së Urakës dhe fshatit Laç, komuna Rukaj, 230 m mbi nivelin e detit,. Është burimi i madh karstik, me ujë të pastër dhe të ftohtë, që del në kontaktin midis gëlqerorëve dhe terrigjenëve. Përdoret për popullsinë, ujitje etj. Ka vlera shkencore hidrologjike, didaktike turistike. Mund të vizitohet sipas rrugës Burrel-Shoshaj-Urakë.

19. Biomonumente:

10. Lisi i Qershizës. Gjendet në juglindje të liqenit të Ulzës, pranë rrugës Shoshaj-Bruç, mbi varrezat e fshatit, rreth 250 m mbi nivelin e detit. Është qarr me kurorë ombrellore, lartësi 15 m, diametër trugu 1 m, moshë 200 vjet. Në trung rritet bimë tjetër parazite (2-3 m lartësi).Ka vlera shkencore biologjike ekologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Shoshaj-Bruç.

11. Lisi i Tushës. Gjendet pranë fshatit Frankth, 800 m mbi nivelin e detit. Është dru me kurorë në formë kërpudhe, lartësi 20 m, diametër të trungut rreth 2,4 m dhe moshë mbi 150 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Frankth.

12. Lisat e Lam Pores. Gjendet në fshatin Macukull, 700 m mbi nivelin e detit. Janë drurë me 16 m lartësi, diametër të trungut 110 cm dhe perimetër 340 cm, perimetri i kurorës ombrellore arin 25 m dhe mosha mbi 320 vjet. Kanë vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Macukull.

13. Lisi i Qafë Shënkollit. Gjendet në afërsi të fshatit Dukagjin, 650 m mbi nivelin e detit, me kurorë piramidale, lartësi 21 m, diametër të trungut 1 m dhe moshë mbi 250 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike dhe turistike. Mund të vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Dukagjin.

14. Qarri i Bardhë në Shoshaj. Gjendet në fshatin Shoshaj, me lartësi mbi 14 m, diametër të trungut mbi 60 m e perimetër të tij rreth 200 cm. 7 degë formojnë kurorën me perimetër mbi 34 m dhe moshë mbi 200 vjet. Vlerat janë shkencore biologjike, didaktike e turistike. Vizitohet sipas rrugës këmbësore Ura e Shoshanit-fshati Shoshaj.

15. Lisi i Bërshinit. Gjendet në fshatin Bërshin, komuna Klos, 440 m mbi nivelin e detit. Është dru bunge i shenjtë, me lartësi 18 m, diametër të trungut 100 cm e perimetër të tij 290 cm dhe moshë 270 vjet. 12 degë formojnë kurorën me perimetër 23 m. Ka shërbyer si vendtakim për biseda, mbledhje etj. Ka vlera shkencore biologjike didaktike, shpirtërore dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale-Klos-Bërshin

16. Lisi i Varrit të Mirë. Gjendet rreth 2.5 km larg qendrës së fshatit Macukull, në vend të shenjtë. Përfaqëson dru shparthi me kurorë ombrellore, lartësi rreth 20 m, diametër të trungut 80 cm dhe perimetër 220 cm, ndërsa i kurorës 22 m dhe mosha 280 vjet. Ka vlera shkencore biologjike, didaktike, turistike e fetare. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrelit-Macukull.

17. Lisi i Varrit të Turkut. Gjendet në fshatin Vig të komunës Macukull, pranë një varri të hershëm. Përfaqëson dru disi të veçuar nga shtatë të tjerë më të vegjël, me kurorë ombrellore, lartësi rreth 22 m, diametër trungu 70-130 m, moshë 120-140 vjet. Ka vlera biologjike, didaktike, fetare. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Vig-Fushë Bunar.

18. Lisat e Shkollës. Gjenden në qendrën e fshatit Macukull, rreth 1000 m mbi nivelin e detit. Është grup drurësh qarri, rreth 1 ha. Lartësia e drurëve arrin 24 m, diametri i trungut 40-50 cm, mosha 120-140 vjet. Pranë tyre janë mbledhur banorët për takime, biseda. Kanë vlera biologjike, estetike, historike, turistike. Vizitohen sipas rrugës rurale Burrel-Macukull.

19. Lisi tek varret e Shqypit. Gjendet në afërsi të fshatit Barbullej të komunës Derjan, rreth 600 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru qarri me moshë 230 vjeçare. 8 degët, që zënë fill në lartësinë 3 m mbi sipërfaqen e tokës, formojnë kurorë ombrellore me lartësi 21 m dhe perimetër 21 m, diametër të trungut 90 cm dhe perimetër 280 cm.. Ka vlera biologjike, didaktike, estetike. Vizitohet sipas rrugës rurale Shoshaj-Burgajet-Barbullej.

20. Lisi i Kodrës së Varreve. Gjendet në Kodrën e Varreve të fshatit Urxuall të komunës Derjan, 600 m mbi nivelin e detit. Është dru shparthi me dëmtime të pjesëshme nga faktorë natyrorë. Lartësia është 18 m, diametri 90 cm e perimetri 280 cm, ndërsa mosha 280 vjet. 7 degët e tij formojnë kurorë ombrellore me perimetër 18 m. Ka vlera biologjike, didaktike e fetare. Vizitohet sipas rrugës rurale Shoshaj-Urxuall.

21. Lisi në Varret e Kurmetës. Gjendet në afërsi të shtëpive të Kurmetëve në fshatin Shqefën të komunës Macukull, 530 m mbi nivelin e detit. Është qarr 260 vjeçar me lartësi 20 m, diametër të trungut 90 cm e perimetër 270 cm. 12 degët e tij formojnë kurorë ombrellore me perimetër 25 m. Ka vlera biologjike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Shoshaj-Shqefën.

22. Lisi i Teqesë së Domit. Gjendet pranë Teqesë së fshatit Batër, komuna Koms, 333 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru shparthi 220 vjeçar me lartësi 8 m, diametër trungu rreth 50 cm dhe perimetër rreth 130 cm. 4 degë formojnë kurorë ombrellore me perimetër 16 m. Vlerat janë biologjike, didaktike e fetare. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Koms-Batër e Madhe.

23. Lisat e Kishës Groshot. Gjenden në fshatin Dukagjin të komunës Derjan, rreth 700 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson grup drurësh lisi 100 vjeçar, lartësi 10 m, diametër të trungjeve 30-40 cm. Kodra ku ndodhen është vend i shenjtë. Kanë vlera biologjike, didaktike, estetike e fetare. Vizitohen sipas rrugës rurale Shoshaj-Dukagjin-rruga këmbësore tek monumenti

24. Bërshini në Groshot. Gjendet afër fshatit Dukagjin, 600 m mbi nivelin e detit. Është dru i veçuar, me lartësi 10 m, diametër të trungut 30 cm e perimetër të tij 50 cm. Banorët e konsiderojnë dru të veçantë. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike, fetare. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Dukagjin dhe ajo këmbësore në Groshot.

25. Tisat e Mbasdejës. Gjenden pranë fshatit Vinjoll të komunës Lis, 1500 m mbi nivelin e detit. Përbëjnë një grup drurësh tisi me kurorë piramidale, 10–13 m të lartë, 18–20 cm diametër të trungut dhe moshë 70 vjet. Kanë vlera shkencore biologjike, didaktike e turistike. Vizitohen sipas rrugës rurale Burrel-Vig-Mbasdejë.

26. Rrapi i Çelës. Gjendet në qendër të fshatit Patin të komunës Klos, 480 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dru të veçuar 220 vjeçar, me lartësi 18 m, diametër të trungut 70 cm dhe perimetër 250 cm. 6 degë formojnë kurorë piramidale me perimetër 14 m. Ka vlera biologjike, didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Klos-Patin.

27. Rrapi i Marqethit. Gjendet pranë fshatit Lis, të komunës me të njejtin emër, 800 m mbi nivelin e detit. Është dru i veçuar 180 vjeçar, me kurorë në formë ombrelle, lartësi 20 m, diametër të trungut 120-130 cm. Ka vlera shkencore biologjike, ekologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Burrel-Lis.

28. Rrapi i Zabelit. Gjendet në fshatin Gurrë e Madhe të komunës me të njejtin emër, 750 m mbi nivelin e detit. Është dru 160 vjeçar, me lartësi 22-25 m, me diametër të trungut 160 cm e perimetër 370 cm. Ka 18 degë, vlera biologjike, estetike, didaktike. Vizitohet sipas rrugës rurale Klos-Gurr